



KUSHTETUTA NA E MBRON TË DREJTËN E SHKOLLIMIT

KUSHTETUTA



TË BASHKËPUNOJMË PËR NJË VEND DEMOKRAT

GRETA (14), ELODI (13), MERIOLA (14), AMBROZI (14), DRINI (14), VALDI (14), ENDRI (14), ART (13),
BESNIK (14), MIC (15)



Në këtë artikull, ju të dashur lexues të rregullt të gazetës „Demos-ti“, do të informoheni për sistemin më të mirë të qeverisjes, demokracinë

A keni menduar ndonjëherë se si do të ishte jeta pa demokraci? Pa këtë sistem të qeverisjes, ne nuk do të kishim fjalën e lirë dhe të tjerët do të zgjedhnin për ne. Si mendoni se do t'ia bënit ju nëse do të kishte pa-barazi dhe diskriminim në jetën tuaj? Të gjitha këto mund t'i shprehim përmes demokracisë.

Demokracia është mënyra më e drejtë dhe më e mirë për të shprehur pakënaqësitë që mund të shfaqen për çështje dhe situata të ndryshme.

Çka nëse dikush për një zgjedhje që ju duhet ta bëni do ta impononte vendimin tuaj në atë zgjedhje? Demokracia është prapë zgjidhja për vetëdijësimin e të gjithë bashkëqytetarëve, sepse ne jemi piktorët e jetës sonë. Vendimet tona bazohen në interesat personale, ruajtjen e dinjitetit të vetes dhe të të tjerëve, si dhe në krijimin e një të ardhme të ndritur për të gjithë.

Andaj, ne e ndjejmë veten të sigurtë në çdo hap që bëjmë, sepse e dijme që jetojmë në bazë të parimeve të demokracisë të cilat janë shumë të çmuara.


Kur jemi duke i përmendur parimet e demokracisë, po iu referohemi barazisë, tolerancës, paqes, respektit, solidaritetit dhe lirisë. Këto parime i japin vlerë dhe fuqi këtij sistemi. E meqenëse demokracia na ofron kaq shumë të mira neve qytetarëve, atëherë e kemi përgjegjësi të mendojmë se si ne mund të ndikojmë në zhvillimin e vazhdueshëm të saj. Prandaj, duam që të

parashtrojmë një pyetje për të gjithë ju. A e dini se cili është roli juaj në demokraci?

Përgjigjen e saj e gjeni, po ashtu, duke u bazuar në vetë kuptim e fjalës *demokraci*. Kjo fjalë do të thotë se qeverisja i takon popullit. Andaj, duke qeverisur ju vetëm sa e rritni dhe e zhvilloni nivelin e demokracisë tutje. Gjithashtu, duke qenë pjesëmarrës aktiv në vendimet shtetërore, duke votuar, duke shprehur mendimet lirshëm, duke qenë tolerant, paqësor, bashkëpunues, zemër e mendjehapur, duke i respektuar dhe duke i trajtuar të gjithë në mënyrë të barabartë mund të bëjmë progres demokratik. Çelësi i një jetese të mirë është demokracia, të jetosh në një botë me barazi dhe liri ku nuk cenohen të drejtat e tua dhe të gjithë të trajtohen me respekt dhe sinqeritet. Mos harroni, titulli i artikullit tonë thotë: të bashkëpunojmë për një vend demokrat, që nënkupton se pa bashkëpunim nuk mund ta bëjmë më të mirën për vendin tonë.



Grupi Kreativët



Kjo është ajo kuti që sjell ndryshim




Dhe që na mundëson të drejtën për të vendosur vetë



Ndjehemi dhe trajtohemi në mënyrë të barabartë



Pa asnjë lloj dallimi të mundshëm




Sepse fuqia është në duart tona



Andaj, jemi kurioz të dijmë për zhvillimet në vend

PSE NJË QYTETAR DUHET TË VOTOJ?

RREZON (14), BLEND (14), EDIS (14), JON (14), ELIZA (14), ARDIT (14), ERION (14), INVA (14),
GOJART (14), LYRA (13)



Qytetarët duhet të votojnë sepse përmes votës ata vendosin për: arsim më të mirë, shëndetësi më të mirë, ekonomi më të mirë, etj. Bëhuni edhe ju pjesë e qytetarëve të cilët votojnë. Një votë, shumë ndryshim!

Në këtë vizatim kemi paraqitur disa qytetarë të cilët kanë dalur për t'i dëgjuar programet politike të disa partive. Këta qytetarë po mundohen që të informohen drejt, në mënyrë që kur të votojnë të zgjedhin dikë që do të përmirësoj jetën e tyre


Në jetën tonë, ne mundohemi të bëjmë zgjedhjen më të mirë...

Në demokraci qytetarët janë të lirë që vetë të vendosin për të ardhmen e tyre. Ata janë të lirë të bëjnë zgjedhje të paimponuara, qoftë për jetën e tyre personale, qoftë për atë shoqërore. Ajo çka kërkohet nga ne është kujdes dhe vëmendje e shtuar kur jemi pranë vendimeve të rëndësishme. Pra, të zgjedhurit është proces që di të jetë sa i rëndësishëm, aq edhe i ndërlikuar.

Nëse flasim për zgjedhjet që i bëjmë vetëm për veten tonë apo edhe për familjarët tanë, ndikimi i tyre ka përmasa më të vogla sesa në zgjedhjet shtetërore. Kjo vie si rezultat i asaj që në zgjedhjet tona personale jo çdo herë e mendojmë cili do të jetë efekti dhe ndikimi i atyre zgjedhjeve. Përgjegjësia që nëse diçka nuk shkon mirë, bie vetëm mbi personin që e bën zgjedhjen. Kurse, në zgjedhje shtetërore nëse ndodh të bëjmë ndonjë zgjedhje të gabuar, atëherë kjo nuk do të ishte vetëm në dëm të personit, por edhe në të tjerëve.

Një pjesë e të qenurit qytetar i rregullt dhe aktiv i një vendi është votimi. Të votojmë do të thotë të vendosim për vendin tonë. Pra, përveç në zgjedhjet tona të përditshmërisë, ne kur të arrijmë moshën 18 vjeçare kemi të drejtë të marrim pjesë edhe në zgjedhjet shtetërore. Ashtu siç kanë rëndësi zgjedhjet tona në shoqëri dhe familje, ashtu kanë edhe zgjedhjet lokale dhe qendrore. Zgjedhjet lokale janë ato zgjedhje në të cilat qytetarët votojnë për kryetarin e komunës përkatëse dhe asamblistët. Ndërsa, zgjedhjet qendrore (parlamentare) janë ato zgjedhje në të cilat populli i zgjedh deputetët. Rëndësia e të dy llojeve të zgjedhjeve është shumë e madhe. Në to votohet për të ardhmen e qytetarëve dhe të vendit po ashtu. Kështu pra,

VOTONI PËR TË ARDHMEN TUAJ!



Në këtë kuti votohet për një të ardhme më të mirë





E ardhmja e ndritur arrihet me ne

120 PËRFAQËSUES TË POPULLIT

ABDULBASIT (14), ALB (14), REDON (14), AZRA (14), EMA (14), ALBA (14), LEA (14), SIHANA (14),

ENEIDA (14)



Përshëndetje, të dashur lexues. Ne jemi klasa IX-4 nga shkolla „Mazlum Këpuska“. Nëse dëshironi të merrni informata lidhur me Kuvendin e Kosovës, ne do t'ju tregojmë pikërisht për të. Prandaj, lexojeni artikullin tonë

Të nderuar lexues të këtij artikulli, kemi vendosur të flasim për Kuvendin e Kosovës. Kuvendi është një institucion ligjvënës, ku deputetët miratojnë ligjet dhe përfaqësojnë popullin. Kuvendi i Kosovës ka gjithsej 120 përfaqësues. 100 deputetë janë shqiptarë, 10 janë serbë, ndërsa 10 të tjerë janë nga komunitetet e ndryshme të cilët jetojnë në Kosovë. Kryetari i Kuvendit, nënkryetarët, Qeveria dhe Presidenti zgjedhen nga shumica e votave të deputetëve, andaj ky rol është shumë i rëndësishëm.

Tri funksionet kryesore të Kuvendit janë: funksioni përfaqësues, legjislativ dhe ai kontrollues. Funksioni përfaqësues do të thotë se deputetët përfaqësojnë popullin, pasi që ata i marrin votat nga ne. Funksioni legjislativ apo funksioni ligjvënës do të thotë se deputetët e kanë për detyrë të nxjerrin dhe miratojnë ligje. Kurse, funksioni kontrollues përshkruan rolin e deputetëve të cilët kanë për të kontrolluar punën e Qeverisë. Ky institucion neve na la shumë mbresa, sepse ka rol shumë të madh në jetën tonë. Por, si ndikon saktësisht Kuvendi në jetën tonë, të dashur lexues? Atëherë, ligjet na ndihmojnë të kemi një jetë më të qetë dhe më të rregullt. Ne kemi lloje të ndryshme të ligjeve, duke filluar nga të gjitha sferat e jetës. Ligjet

na ndihmojnë që të gjithë të trajtohem në mënyrë të barabartë pavarësisht moshës, gjinisë, fesë apo racës. Një ndër ligjet është edhe ligji për të drejtën e votës. Ky ligj thotë se e drejta e votës mund të shfrytëzohet që nga moshja 18 vjeçare. Nga ligjet mund të kuptojmë se ato janë formuar për të plotësuar nevojat dhe për të jetësuar të drejtat e popullit.

Ligji për arsimin është ligji më i rëndësishëm për një popull. Sepse, siç e dijme e ardhmja e vendit jemi ne. Nëse ky ligj nuk do të ishte, atëherë do të ishim një popull i pashkolluar dhe kushtet e jetesës do të vesh-tirësoheshin.

Për grupin tonë, gjëja më e rëndësishme që na jep Kuvendi ynë është shkollimi. Andaj, ne premtojmë se do të vazhdojmë të mësojmë, në mënyrë që ne të rritemi e të bëhemi qytetarë të denjë demokratik.

Ky ishte artikulli ynë për Kuvendin e Kosovës, institucioni më i rëndësishëm dhe më demokratik. Shpresojmë se keni mësuar gjëra të reja nga ne. Mirëupafshim!



Gazetarët e këtij artikulli



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Mazlum Këpuska“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-4
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjakovë